



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Vushtrri, më 03.05.2013

02Nr.587/13

Në mbështetje nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, në bazë të nenit 3 të Rregullores për rekrutimin, nr.02/2010 dhe në bazë të vendimit, 02nr.446/13, Kryetari i komunës, shpall:

K O N K U R S

Rishpallje

Për vendin e punës:

Drejtoria për buxhet dhe financa

I.Vendi i punës: **Zyrtar për çështje ligjore-çështje administrative**

Numri i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi

- Pranon, protokollon, vendosjen e lëndës lidhur me ankesat e palëve për tatim në pronë;
- Përgatit lëndën lidhur me ankesat e palëve për Bordin e Ankesave për Tatim në Pronë;
- Jep këshilla ligjore lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me tatimin në pronë.
- Evidenton të gjitha lëndët e drejtorisë në sistemin elektronik të të dhënave të komunës;
- Jep mendime profesionale për çështje ligjore në kuadër të drejtorisë;
- Kryen edhe punë të tjera në përputhje me ligjin me kërkesë të menaxherit drejtues.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

Master i juridikut

-Trajnime të ndryshme nga fusha e administratës publike ose shërbimit civil

-Njohja e mirë e punës në kompjuter në programet word ,exel;

Kategoria funksionale: Profesionale

Lloji i vendit të punës: **Nëpunës i karrierës**

Koeficienti i pagës 7

Periudha e provuese; një(1) vit .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimi ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimi. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet, të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

**Kryetari i komunës
Bajram Mulaku**